



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	16.02.2026
01 NR/BR.	42/26
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për lirim-faljen e qirasë për shoqatën "Yjet e Zemrave" me adresë në rr. "Uran Tinova".

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për;

1. Lirim-faljen e qirave për lokalit me nr. P-72217092-00714-4-22-2-1-0 me adresë në rr. "Uran Tinova" në pronësi të Komunës së Ferizajt.
2. Shuma totale e qirasë për falje është 4,712.00 €.
3. Obligohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të bëjë shlyerjen e obligimeve për Shoqatën e Personave të Zhdukur "Yjet e Zemrave", me numër fiskal 60183035, për shumën e obligimeve të qirasë sipas pikës 2 të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Shoqatën për Persona të Zhdukur "Yjet e Zemrave", përmes përfaqësuesit të saj ka bërë kërkesë për faljen e obligimeve të qirasë sepse shuma e qirasë është e papërballueshme për shoqatën dhe e njëjta nuk ka mundësi financiare ta paguaj dhe se shpreson në të ardhmen Komuna OJQ-së në fjalë t'i siguroj një lokal pa qira.

Andaj bazuar të atë që u tha më lart i propozoj Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendit të Komunës që të aprovoj propozimin në tërësi ashtu siç edhe është prezantuar në dispozitiv.

Të bashkangjitur gjeni;

- Kontratën e Qirasë me nr. 01/185/22 e datës 26.07.2022;
- Kartelën Financiar;
- Kërkesën për falje të qirasë nga shoqata "Yjet e Zemrave".



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJ • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREZTORIA E ADMINISTRATES DNE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datese / Izlazne: Data / Dana: 26.10.2022		
Nr. Orgv: 01	Nr. Prot. 185/22	Nr. Fageve. 3
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJ • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KONTRATË

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË KOMUNËS

E lidhur në Ferizaj me datën: 26.07.2022 në mes të palëve kontraktuese:

1. Komuna Ferizaj, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Agim ALIU, në njërën anë (në tekstin vijues: Komuna).
2. SH.F.PZH "Yjet e zemrave", me nr. Fiskal 601830351 përfaqësuar nga Sali Muhaxheri Ferizaj, Rruga "Uran Tinova" Nr.P72217092-00714-4-22-2-1-0.

Kontrata bazën ligjore e ka në këto dokumente juridiko-ligjore:

1. Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtëre e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019 Prill 2019);
2. Rregullores QRK Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
3. Vendimin 01 Nr. 44 të datës 28.02.2022 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
4. Ankandi Publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale të datës 28.04.2022.

Neni 1

LËNDA E KONTRATËS

- 1.1 Lënda e kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën kohore prej 15 viteve të pronës lokalit afarist me Nr. P72217092-00714-4-22-2-1-0, i cili gjindet në rrugën "Uran Tinova" Lokali ka 22.88 m² dhe çmimi i ofruar nga përfituesi është 124.00 € (Njëqind e njëzetë e katër Euro) për 1 (një) Muaj.
- 1.2 Pagesa e qirasë bëhet në llogarinë rrjedhëse duke u thirrur në UNIREF-in dhe qëllimin e pagesës.
Xhirollogaria e Komunës Nr.1000650030000035.

Neni 2.

- 2.1 Palët kontraktuese janë dakorduar që prona nga neni 1, paragrafi 1.1. i kësaj kontrate ti jepet në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën prej 15 viteve, duke llogaritur nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate për periudhë afatshkurtër prej 26.07.2022 deri 25.07.2037.

Neni 3

3.1 Shfrytëzuesi obligohet që për shfrytëzimin e pronës afatshkurtër nga neni 1. Paragrafi 1.1 i kësaj kontrate me kushtet e parapara të paguaj shumën e lartëcekur në nenin 1 paragrafi 1 për shfrytëzimin e hapësirës deri me datën 05 të muajit rrjedhës.

3.2 Nëse dita e paguesë bie në ditën kur nuk punohet, shfrytëzuesi i pronës është i obliguar të paguaj këstin mujor në ditën e parë të ditës së punës që vjen.

3.3 Nëse shfrytëzuesi nuk e paguan qiranë në tërësi apo ndonjë pjesë të saj për të cilën është i obliguar sipas kësaj kontrate, Komuna mund të ja shkëput njëanshëm kontratën me paralajmërimin prej 1 muaj paraprakisht.

3.4 Pala përfitues duhet të bëjë pagesën e qirasë për tre muaj paraprakisht para se të nënshkruaj kontratën. Pagesa bëhet sipas vlerës së ofertuar.

3.5 Sigurimi i kontratës duhet të bëhet për çdo vitë dhe fillon prej momentit të nënshkrimit të kontratës. Ai dorëzohet me datën e njëjtë të operimit dhe dorëzohet çdo vitë në datën e njëjtë kur skadon afati i sigurimit.

Neni 4

4.1 Nëse me plan regullativ ose me vendim të komunës zona ku gjendet objekti shpallet interes i përgjithshëm, shfrytëzuesi obligohet të liroj lokalin në të cilin gjendet në afat prej 30 ditëve pas paralajmërimit me shkrim, pavarësisht nga validiteti i kontratës.

Neni 5

5.1 Shfrytëzuesi në kohën sa e shfrytëzon pronën e marr në shfrytëzim, i mbartë të gjitha shpenzimet që lidhen me pronën.

Neni 6

6.1 Shfrytëzuesi është i obliguar të kujdeset për ruajtjen e pronës komunale të marr në shfrytëzim dhe nuk ka të drejtë të bëjë ndërtime ose përmirësime pa lejen e organit kompetent.

Neni 7

7.1 Shfrytëzuesi ka për obligim pagesat e tatimit në pronë dhe pagesat tjera komunale dhe shtetërore si shfrytëzues i pronës.

Neni 8

8.1 Shfrytëzuesi nuk mund t'ia bartë personit fizik apo juridik të drejtën e shfrytëzimit të pronës nga neni 1, paragrafi 1.1. të kësaj kontrate, as të ndërmerr kurrfarë veprimi juridik që është në kundërshtim me kushtet dhe ligjet e dhënies në shfrytëzim të kësaj prone dhe pa vendim dhe leje parapraka nga ana e komunës.

8.2 SH.F.PZH "Yjet e zemrave", me nr. Fiskal 601830351 përfaqësuar nga Sali Muhaxheri Ferizaj nuk mund ta bartë të drejtën e shfrytëzimit pa leje të komunës sepse ai është vetëm shfrytëzues i parcelave të parapara në nenin 1 kurse pronar është Komuna e Ferizajt.

Neni 9

9.1 Shfrytëzuesi për aplikim për leje ndërtimore duhet të bëjë konform ligjeve në fuqi si dhe është i obliguar të bëjë të gjitha pagesat e parapara me rregulloret dhe ligje për secilën prej procedurave të cekura më lartë dhe procedurave tjera.

Neni 10
SHKËPUTJA E KONTRATËS

10.1 Komuna do ta shkëput këtë kontratë me veprim të njëanshëm në rast se:

- a) Shfrytëzuesi nuk i përmbush obligimet dhe nuk fillon punën sipas afateve të parapara me kontratë.
- b) Në rast, se pala e ndryshon destinimin pa leje të organeve kompetente për të cilën i është dhënë prona në shfrytëzim dhe bën ndërtime ose intervenime në pronë pa leje të organeve komunale dhe atyre shtetërore mund t'i shkëputet kontrata.
- c) Vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 8.1 të kësaj kontrate.
- d) Nëse i duhet prona Komunës, për çështje të interesit të përgjithshëm, ose me ndryshimet e planeve urbanistike konform ligjeve që rregullojnë këtë fushë, Komuna mund ta marrë pronën e saj dhe të kompensoj shfrytëzuesin për investimet në përputhje me vlerat e tregut.
- f) Nëse mësohet se informatat e dhëna të paraqitura në aplikacion ose në dokumente tjera të cilat pala i ka paraqitur, nuk janë saktë, të njëjtit mund t'i shkëputet kontrata me paralajmërimin e caktuar në afat prej 1 muaj.

Neni 11

11.1 Në rast se realizimi i kësaj kontrate e pengon me një vendim ndonjë organ shtetëror, kjo kontratë konsiderohet nule dhe nuk prodhon efekte juridike.

11.2 Për rastin e paraparë në paragrafin 9.1 të këtij neni komuna nuk mban kurrfarë përgjegjësie për dëmet dhe pasojat që do ti shkaktohen me këtë rast shfrytëzuesit.

Neni 12

12.1 Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do ti zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje, dhe në rast se këtë nuk mund të arrijnë atëherë kontestet do të zgjidhen në Gjykatën Kompetente.

Neni 13


Çdo gjë nuk është përparësi sipas kësaj kontratës për shfrytëzim afatshkurtër, do të zbatohen dispozitat e LMD-së dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore.

Neni 14


13.1 Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplar të mjaftuar për palën kontraktuese, palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

KONTRAKTUESIT

Komuna – Ferizaj


Agim ALIU
Kryetar i Komunës së Ferizajt

Pala Përfituese


Sali Muhaxheri

Analitika e qeramarrsit me gjendje nga:2016 deri 2024

Subtotal :					5,332.00 €		620.00	
2014 & 2025					Saldo :		4,712.00	
Unire fi	Qiramarrsi	Dokumenti	Përshkrimi	Data	Obligimi	Pagesa		
431	Sali Muhaxheri	25.07.2022	QerajaGusht/2022	1-Aug-22	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri	kontrat. e re	QerajaShtator/2022	1-Sep-22	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		Pagesë	22-Sep-22		124.00 €		
431	Sali Muhaxheri		Pagesë	22-Sep-22		124.00 €		
431	Sali Muhaxheri		QerajaTetor/2022	1-Oct-22	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaNëntor/2022	1-Nov-22	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaDhjetor/2022	1-Dec-22	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		Pagesë	8-Dec-22		124.00 €		
431	Sali Muhaxheri		QerajaJanar/2023	4-Jan-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaShkurt/2023	1-Feb-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		Pagesë	8-Feb-23		124.00 €		
431	Sali Muhaxheri		QerajaMars/2023	1-Mar-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaPrill/2023	1-Apr-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		Pagesë	24-Apr-23		124.00 €		
431	Sali Muhaxheri		QerajaMaj/2023	1-May-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaQershor/2023	1-Jun-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaKorrik/2023	1-Jul-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaGusht/2023	1-Aug-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaShtator/2023	1-Sep-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaTeor/2023	1-Oct-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaNentor/2023	1-Nov-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaDhjetor/2023	1-Dec-23	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaJanar/2024	1-Jan-24	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaShkurt/2024	1-Feb-24	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaMars/2024	1-Mar-24	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaPrill/2024	1-Apr-24	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaMaj/2024	1-May-24	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaQershor/2024	1-Jun-24	124.00 €			
431	Sali Muhaxheri		QerajaKorrik/2024	1-Jul-24	124.00 €			

431	Sali Muhaxheri			QerajaGusht/2024	1-Aug-24	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			QerajaShtator/2024	3-Sep-24	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			QerajaTetor/2024	1-Oct-24	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			QerajaNentor/2024	4-Nov-24	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			QerajaDhjetor/2024	2-Dec-24	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Janar/2025	13-Jan-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Shkurt/2025	3-Feb-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Mars/2025	3-Mar-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Prill/2025	3-Apr-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Maj/2025	2-May-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Qershor/2025	4-Jun-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Korrik/2025	2-Jul-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Gusht/2025	4-Aug-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Shtator/2025	3-Sep-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Tetor/2025	3-Oct-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Nëntor/2025	5-Nov-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Dhjetor/2025	3-Dec-25	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Janar/2026	8-Jan-26	124.00 €	
431	Sali Muhaxheri			Qeraja Shkurt/2026	3-Feb-26	124.00 €	